



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/39

Datë: 31.07.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr.03/L-40, si dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Junikut dhe kompetencat e Kuvendit Komunal për planifikim dhe zhvillim lokal, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.07.2026 nxjerrë:

V E N D I M

për miratim në lexim të parë të strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Junikut për periudhën 2026-2033

I. Me këtë vendim miratohet në lexim të parë strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Junikut për periudhën 2026-2033

II. Pas miratimit në lexim të parë, drafti i strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal i nënshtrohet procedurave të konsultimit publik, shqyrtimit nga komitetet përkatëse të Kuvendit të Komunës dhe plotësimeve eventuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. Drejtoria Komunale për Zhvillim Ekonomik obligohet që, pas përfundimit të konsultimeve dhe inkorporimit të rekomandimeve të pranuar, ta procedojë dokumentin në Kuvendin e Komunës për miratim në lexim të dytë.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Junikut.

V. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrit përgjegjës për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Junikut,
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Elahuni

